



Ministri i Mbrojtjes Peleshi, takime sensibilizimi me drejtuesit vendorë

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shoqëruar nga drejtori i Agjencisë së Mbrojtjes Civile Haki Çako, nisi nga Korça një tur takimesh me strukturat e Emergjencave Civile, kryetarët dhe prefektët, që do të vijojë në të gjithë vendin. Qëllimi i këtyre takimeve është i njëjste vendore për identifikimin e hershëm dhe eliminimin e vatrave potenciale të zjarreve për të mos lejuar degradimin e situatave, veçanërisht gjatë sezonit veror. "Ju kërkohet të parë qytetarisht mirëkuptim dhe bashkëpunim, së

dyti ligjërisht. Nuk mund të vazhdojë më kështu, që kur bie një zjarr diku, bashkia bën sikur nuk e shikon, pret sa zjarri të marrë një përmasë të qenësishme dhe pastaj i bie telefonit të marrë helikopterin. Kështu ka ndodhur deri tani. Ne do bëjmë tonën, edhe për rritjen e gatishmërisë së helikopterëve, kemi lajme shumë të mira edhe nga Komisioneri i Emergjencave Civile, të cilit i dhamë aplikimin zyrtar për t'u bërë anëtarë të Mekanizmit Europian. Kemi marrë sigurinë që do të na përgjigjen,

sepse ndonjëherë nuk mjaftojnë as 2 helikopterë, as 5, as flota ndonjëherë, kur vatrat e zjarrit janë të shpërndara në të gjithë Shqipërinë siç ishin vitin e kaluar dhe siç parashikojmë të jenë edhe këtë vit", - u shpreh para drejtuesve vendorë ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi. Z. Peleshi propozoi që puna duhet të nisë me edukimin e komuniteteve që të reagojnë në raste të tilla, punë kjo që duhet të fillojë që nga kryepelqët e fshatrave. Ai u la porosi prefektëve... >>> faqe 3



Nga 1 korriku rriten me 30 % pagat e ushtarakëve

Ministri Peleshi: Rritje historike e pagës së ushtarakëve, mirënjohës kryeministrit Rama, për vlerësimin e FA-së



Zëvendësministria Bici: Ju do të jeni zëri, fuqia dhe dinjiteti i Shqipërisë në mes të aleatëve tanë në këto kohë të vështira

Kontingjenti i XI i EOD u nis në misionin e Prezencës së Përfunduar të Përfunduar të NATO-s, në Letoni. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast morën pjesë zëvendësministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici dhe zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu. Në fjalën e saj, zëvendësministria e Mbrojtjes tha se ky kontingjent nisët në këtë detyrë si pjesë e angazhimeve që Forcat e Armatosura shqiptare kanë... >>> faqe 2



Historia e suksesit 88-vjeçar të Armës së Tankeve

Më 24 qershor 1928, me daljen e dekretit të mbretit Zog, krijohet Arma e Tankeve, një njësi mjaft e rëndësishme për ushtrinë shqiptare. Me një histori të gjatë sukcesi dhe me ushtarakë të përkushtuar, fuqia dhe kapaciteti i saj u rritën ndjeshëm, po ashtu dhe impakti që kjo armë pati në sytë e fqinjëve tanë, për këto dhe lavdinë e suksesit të kësaj arme, për gazetën "Ushtria" në këtë 88-vjetor, ish-komandanti i kësaj Arme, kolonel Budjon Arapi do sjellë emocionet dhe punën e palodhur të efektivëve në vite. Kolonel Budjon Arapi, skënderbegas në vitet 1962-1966, Shkolla... >>> faqe 3



15 vjet Qendra e Personel Rekrutimit

22 qershori i vitit 2007 shënon datën e krijimit të strukturës së QPR-së. Pas krijimit, Qendra e Personel Rekrutimit (QPR) si pasojë e riorganizimit të FA gjatë periudhës nga krijimi deri sot, ka kaluar në disa faza të zhvillimit të saj. Qendra e Personel Rekrutimit (QPR) është njësi mbështetëse e Shtabit të Përgjithshëm. Ajo rekruton kandidatë për oficerë e ushtarë/detarë profesionistë, përpunon dhe administron dokumentacionin dhe të dhënat e personelit të ushtarakëve aktivë, në rezervë/lirim dhe atij civil, si dhe realizon trajtimin financiar të ushtarakëve në rezervë/lirim. QPR, pajis shtetasit... >>> faqe 8



Niset me mision në Letoni Kontingjenti i XI i EOD

Zëvendësministrja Bici: Ju do të jeni zëri, fuqia dhe dinjiteti i Shqipërisë në mes të aleatëve tanë në këto kohë të vështira

Kontingjenti i XI i EOD u nis në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar të NATO-s, në Letoni. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast morën pjesë zëvendësministrja e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici dhe zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu.

Në fjalën e saj, zëvendësministrja e Mbrojtjes tha se ky kontingjent nis në këtë detyrë si pjesë e angazhimeve që Forcat e Armatosura shqiptare kanë në kuadër të detyrimeve ushtarake euro-atlantike të vendit. “Veçanërisht agresioni i paprecedentë rus e ka rritur ndjeshëm rëndësinë e këtij misioni duke e kthyer atë në vijën e parë të frontit të Aleancës që gjithmonë e më shumë duket se po bëhet një vijë kritike. Kjo situatë kërkon rritjen e përkushtimit tuaj në këtë front të Aleancës. Ju do të jeni zëri, fuqia dhe dinjiteti i Shqipërisë në mes të aleatëve tanë në këto kohë të vështira. Por, ju do të jeni edhe krenaria e Forcave të Armatosura dhe familjeve tuaja”, - iu drejtua zëvendësministrja Bici, efektivëve të kontingjentit të XI që nisen me mision në Letoni.

Zëvendësministrja e Mbrojtjes



përmendi më tej vështirësinë që kanë misione të tilla, pavarësisht eksperiencës disavjeçare që FA-të kanë, duke siguruar në të njëjtën kohë kujdesin

dhe vëmendjen e veçantë që Ministria e Mbrojtjes ka ndaj efektivëve të FA-së. Zëvendësministrja falënderoi edhe Zyrën e Bashkëpunimit

Ushtarak të SHBA-ve për vëmendjen dhe mbështetjen e vazhdueshme të Shqipërisë në këto angazhime ushtarake për sigurinë kolektive.

Pjesë e ceremonisë ishin edhe komandantë të forcave në FA si dhe familjarë të efektivëve të Kontingjentit të XI.



FORCA DETARE

Kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj, komandanti i ri i Flotiljes Detare

Në bazën detare të Pashalimanit u zhvillua ceremonia e ndërrimit të komandantit të Flotiljes Detare. Në ceremoni mori pjesë komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnan Agastra. Kapiten i rangut I Sabri Gjinollari në fjalën e tij vlerësoi arritjet dhe përkushtimin e treguar nga efektivët e Flotiljes në kryerjen e detyrave të ngarkuara gjatë tetëmbëdhjetë muajve të drejtimit të Flotiljes prej tij.

Ndërsa kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj në fjalën si komandanti i ri i Flotiljes Detare siguroi që Flotilja Detare do të vazhdojë të qëndrojë në pararojë të Forcës Detare dhe do të kryejë me sukses të gjitha detyrat që do



t'i ngarkohen.

Komandanti i Forcës Detare në fjalën përshëndetëse vlerësoi punën e kryer nga efektivët në zbatim të

misionit dhe detyrave kushtetuese si dhe kërkoi prej tyre angazhim më të madh në përballimin e ngarkesës gjatë sezonit të verës.

FORCA AJRORE



Helikopteri i Forcës Ajrore ndihmon dy turistë të aksidentuar në Krrabë

Helikopteri i Njësisë së Transportit të Shëndetësisë së Bazës Ajrore Farkë Hkreu dy operacione fluturuese prej 1 orë e 10 minuta për të evakuuar dy turistë të aksidentuar në zonën e Krrabës, në vendin e quajtur “Syri i Ciklopit”. Pjesëmarrja e helikopterit në këtë operacion u bë për shkak të rajonit tepër të thyer dhe të vështirë, në pamundësi për t'i dhënë ndihmën e shpejtë dy turistëve të aksidentuar në rrugë tokësore nga forcat e Policisë së Shtetit dhe strukturat e shëndetësisë. Pas evakuimit me helikopter, turistët e aksidentuar u transportuan në Spitalin Universitar të Traumës në Tiranë për t'iu dhënë ndihma mjekësore.



Nga 1 korriku rriten me 30 % pagat e ushtarakëve

Ministri Peleshi: Rritje historike e pagës së ushtarakëve, mirënjohës kryeministrit Rama, për vlerësimin e FA-së

Nisur nga data 1 korrik i gjithë personeli ushtarak i Forcave të Armatosura do të marrë një rritje page prej 30%. Lajmi u bë i ditur në një konferencë për mediat nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, pas mbledhjes së Këshillit të Ministrave.

“Sot kemi bërë rritjen historike të pagës dhe unë për këtë jam shumë krenar. Jam shumë mirënjohës gjithashtu që premtimi i kryeministrit sot është jetësuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Të gjithë ushtarakët nga ushtari i parë dhe deri tek gradat më të larta nga data 1 korrik, në bazë të këtij vendimi të Këshillit të Ministrave, do të kenë një pagë 30% më të lartë, çka do të thotë që paga minimale në Forcat e Armatosura është më shumë se 51 mijë lekë të reja. Shtuar këtu pastaj edhe pagesa shtesë të trajtimit ushqimor dhe trajtime të tjera sipas vështirësive”, -sqaroi ministri Peleshi.

Shtesë në pagë do të kenë edhe punonjësit e strukturës ushtarake të Mbrojtjes Kibernetike, sektor që ka marrë një vëmendje të shtuar kohët e fundit, sipas ministrit Peleshi.

“Kemi miratuar edhe një aneks, një listë me rreth 38 pozicione apo struktura brenda forcave të Armatosura që marrin shtesë mbi këtë shtesën e



pagës. Mund të veçoj atë që është e para në listën e shtesave edhe që merr shtesën më të lartë, është Struktura Ushtarake e Mbrojtjes Kibernetike. Përveç shtesës 30 % do të marrë dhe 20 mijë lekë të reja shtesë mbi këtë pagë për shkak të rëndësisë që ky domain i ri, pra mbrojtja kibernetike ka marrë sot në Shqipëri dhe në të gjithë botën, sidomos edhe pas ndryshimit të të gjithë skemës së sigurisë, pas 24 shkurtit pra agresionit rus në Ukrainë”, -u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Z. Peleshi bëri të ditur se shtesa mbi pagat janë parashikuar edhe për funksione apo pozicione të tjera të trupave komando, të trupave speciale, të mjekëve që shërbejnë brenda forcave të Armatosura dhe shumë të tjera. Sipas Ministrit të Mbrojtjes ky është një premtim i bërë realitet tashmë, që i jep trajtim dinjitoz dhe prestigj Forcave të Armatosura si dhe për t'i hapur rrugën më shumë prurjeve të reja.

EMERGJENCAT CIVILE


Ministri i Mbrojtjes Peleshi, takime sensibilizimi me drejtuesit vendorë

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shoqëruar nga drejtori i Agjencisë së Mbrojtjes Civile Haki Çako, nisi nga Korça një tur takimesh me strukturat e Emergjencave Civile, kryetarët dhe prefektët, që do të vijojë në të gjithë vendin. Qëllimi i këtyre takimeve është i njëjti vendore për identifikimin e hershëm dhe eliminimin e vatrave potenciale të zjarreve për të mos lejuar degradimin e situatave, veçanërisht gjatë sezonit veror.

“Ju kërkoj së pari qytetarisht mirëkuptim dhe bashkëpunim, së dyti ligjërisht. Nuk mund të vazhdojë më kështu, që kur bie një zjarr diku, bashkia bën sikur nuk e shikon, pret sa zjarri të marrë një përmasë të qenësishme dhe pastaj i bie telefonit të marrë helikopterin. Kështu ka ndodhur deri tani. Ne do bëjmë tonën, edhe për rritjen e gatishmërisë së helikopterëve, kemi lajme shumë të mira edhe nga Komisioneri i Emergjencave Civile, të cilit i dhamë aplikimin zyrtar për t'u bërë anëtarë të Mekanizmit European. Kemi marrë sigurinë që do të na përgjigjen, sepse ndonjëherë nuk mjaftojnë as 2 helikopterë, as 5, as flota ndonjëherë,



kur vatrat e zjarrit janë të shpërndara në të gjithë Shqipërinë siç ishin vitin e kaluar dhe siç parashikojmë të jenë edhe këtë vit”, - u shpreh para drejtuesve vendorë ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi. Z. Peleshi propozoi që puna duhet të nisë me edukimin e komuniteteve që të reagojnë në raste të tilla, punë kjo që duhet të fillojë që nga kryepiqetë e fshatrave. Ai u la porosi prefektëve që të ngrënë strukturat e emergjencave civile në mënyrë që bashkitë të përfitojnë fondet e buxhetit të dedikuara nga qeveria. Ministria e Mbrojtjes ka ndarë këtë vit 10 milionë dollarë për emergjencat civile për bashkitë, fond që sipas ministrit të Mbrojtjes jo kudo është përdorur si duhet.



Brifingu u përqendrua kryesisht në Strategjitë e aprovuar tashmë nga BE, lidhur me ambicien e BE-së për një plan veprimi që do të forcojë dukshëm Sigurinë dhe Mbrojtjen e Unionit deri në vitin 2030.

Projeksioni i zhvillimit në kuadër të BE-së, të Politikave të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Në ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura u zhvillua një brifing mbi projektionin e zhvillimit në kuadër të BE-së, të Politikave të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Dokumenti kryesor me titull “Kompasi Strategjik i BE-së 2022-2030” u prezantua nga atasheu i Republikës Franceze i akredituar në Tiranë, kolonel Nikolas Coussiere, atasheu ushtarak i Gjermanisë në Tiranë nënkolonel Dirk Webers, si dhe përfaqësuesi i BE-së në Tiranë z. Paul Jonas.

Brifingu u përqendrua kryesisht në Strategjitë e aprovuar tashmë nga BE, lidhur me ambicien e BE-së për një plan veprimi që do të forcojë dukshëm Sigurinë dhe Mbrojtjen e Unionit deri në vitin 2030.

Gjithashtu panelistët shpalosën de-



taje mbi këtë plan, mbi objektivat dhe synimet në fushat respektive, gjithnjë në funksion të rolit dhe përgjegjësisë të BE-së për të rritur sigurinë e qytetarëve të vet. Auditori i këtij prezantimi përbëhej nga kursantë të kurseve të larta në Akademinë e Forcave të Armatosura

si dhe kuadro, pedagogë dhe drejtues të Akademisë.

Komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Albert Mullai në fjalën e tij e konsideroi subjektin e këtij takimi shumë të rëndësishëm dhe pjesëmarrjen në të, të Oficerëve me gradën Major



dhe N/Kolonel edhe më të rëndësishme, për faktin që ata do të drejtojnë së shpejti njësitë e repartet e Forcave të Armatosura, duke mundur kështu zbatimin edhe të këtyre masave në kuadër të BE-së dhe NATO-s.

Në takim pati pyetje të shumta dhe

interes të shtuar mbi analizën e riskut mbi intensifikimin e bashkëpunimit dy e shumë palësh, mbi forcimin e kapaciteteve luftarake, mbi forcimin e gatishmërisë, mbi detyrimet lidhur me pjesëmarrjen e forcave të gatishmërisë së shpejti të BE etj.

Konferencë Shkencore: “Rishikimi i Dokumenteve Strategjike, bazë e procesit të planifikimit të mbrojtjes”

Në ambientet e Auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u organizua Konferenca Shkencore “Rishikimi i dokumenteve strategjike, bazë e procesit të planifikimit të mbrojtjes”.

Organizatorët e kësaj konference IKSHU dhe AFA e kishin projektuar zhvillimin e saj në formatin e seancës plenare të zhvilluar me kumtesa për pesë nga punimet kryesore të Konferencës.

Konferencën e hapi Komandanti i AFA gjeneral brigade dr. Albert Mullai dhe më tej ajo u përshëndet nga zëvendësministri i Mbrojtjes znj. Dallëndyshe Bici dhe në emër të SHPPFA përshëndeti edhe Drejtori i SHP gjeneral brigade Bilbil Bitri.

Konferenca u ndoq gjithashtu edhe nga Komandanti i FD, kundëradmiral Adnand Agastra, Komandanti i KM gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, zëvendëskomandanti i FT gjeneral brigade Alfred Dimo, drejtorë të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, profesorë të FA-së dhe kërkues shkencorë nga institucione të tjera si AKMC, përfaqësues nga Akademia e Sigurisë dhe institucione të tjera të arsimit të lartë, pedagogë si dhe kursantë të AFA-së.

Vëmendje të veçantë Konferenca i kushtoi trajtesës së sfidave të sigurisë e cila tërhoqi vëmendjen lidhur me nevojën që vendi ynë duhet të bëjë kujdes në mbajtjen në kontroll kërcënimet dhe rreziqet hibride.

Gjithashtu kujdesi duhet treguar



në luftën kundër terrorizmit për përmirësimin e kapaciteteve të nevojshme dhe reagimit institucional ndaj sulmeve kibernetike.

Tematika e konferencës mundësoi trajtimin e çështjeve që lidhen me sfidat e Forcave të Armatosura për përputhjen e dokumentet kryesore në koherencë me ambientet e sigurisë, sistemin e planifikimit të mbrojtjes së përafuar me atë të NATO-s (NDPP).

Kjo konferencë është një gur themeli në përpjekjet institucionale e shkencore të drejtuara në zbatim edhe të direktivës së Kryeministrit Rama për nevojën e hartimit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, dokument që do i hapë rrugën ripunimit të tërë hierarkisë së dokumenteve që nga SUK e me radhë deri në nivelin operacional taktik. Çështjet e trajtuara do të jetë objekt i rëndësishëm për vijimin e konsolidimit e sistemit të Sigurisë dhe Mbrojtjes së vendit.

VIZITA



Ekipi i QAPN-së, vizitë mësimore në Komandën e Doktrinës të Stërvitjes të FSK-së në Ferizaj, Kosovë

Nga Qendra e Arsimit Profesional të Nënoficerëve, përfaqësues të efektivit të Nënoficerëve të kryesuar nga zëvendëskomandanti, nënkolonel Bedri Qoli, zhvilluan një vizitë mësimore në Komandën e Doktrinës të Stërvitjes të FSK-së në Ferizaj, Kosovë. Ekipi i QAPN-së u prit nga Komandanti i KDS-së, gjeneralmajor Irfete Spahiu. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me strukturat e KDS-së, programet, kurrikulat mësimore, që zhvillohen në Shkollën e Nënoficerëve të KDS-së të FSK-së.

Nga Nënoficerët e QAPN-së u prezantuan kurrikulat mësimore të kurseve që zhvillohen në këtë qendër, si dhe Rregullorja e re e Nënoficerit të Forcave të Armatosura. Gjatë zhvillimit të këtij takimi u diskutua dhe ofrimi i mundësive për pjesëmarrjen e kursantëve të nënoficerëve të FSK-së në kurset që zhvillohen në QAPN.





22 qershori i vitit 2007 shënon datën e krijimit të strukturës së QPR-së. Pas krijimit, Qendra e Personel Rekrutimit (QPR) si pasojë e riorganizimit të FA gjatë periudhës nga krijimi deri sot, ka kaluar në disa faza të zhvillimit të saj.

Qendra e Personel Rekrutimit (QPR) është njësi mbështetëse e Shtabit të Përgjithshëm.

Ajo rekruton kandidatë për oficerë e ushtarë/detarë profesionistë, përpunon dhe administron dokumentacionin dhe të dhënat e personelit të ushtarakëve aktivë, në rezervë/lirim dhe atij civil, si dhe realizon trajtimin financiar të ushtarakëve në rezervë/lirim.

QPR, pajis shtetasit me vërtetime për kryerjen e SHDUA (Shërbimi i Detyrueshëm Ushtarak Aktiv). Në QPR ofrohet shërbimi për llojet e përfitimeve suplementare për ushtarakët në rezervë/lirim apo familjeve të tyre, për: trajtimin me pagesë kalimtare; pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi; pension suplementar; pensionin e plotë të pleqërisë; pension suplementar invaliditeti; pension suplementar familjar; kur për shkak të detyrës, humbasin jetën; etj.

Misioni:

Rekruton kandidatë për oficerë e ushtarë profesionistë, përpunon dhe administron dokumentacionin dhe të dhënat e personelit të ushtarakëve aktivë, në rezervë/lirim dhe atij civil, si dhe realizon trajtimin financiar të ushtarakëve në rezervë/lirim.

Detyrat:

- Rekruton kandidatë për oficerë e ushtarë/detarë profesionistë, sipas planit të miratuar nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së;
- Përgjigjet për standardizimin, automatizimin, administrimin dhe përditësimin e të dhënave të personelit aktiv të FA-së dhe atij në rezervë dhe lirim;
- Realizon trajtimin financiar të ushtarakëve në rezervë/lirim;
- Mbështet me të dhëna personelin,



15 vjet QPR



- Vërtetim për periudhën e trajtimit me pagesë kalimtare;
- Vërtetim për efekt pensioni vjetërsi shërbimi invaliditeti ose familjar (për ushtarakët në rezervë/lirim për efekt pensioni pleqërie.

Si një prej strukturave më të rëndësishme të Forcave të Armatosura, Qendra e Personel Rekrutimit (QPR), ka festuar 15-vjetorin e krijimit të saj, në një ceremoni të organizuar në ambientet e auditoriumit, ku ishin të ftuar drejtues të saj në vite, ushtarakë në pension, por me një kontribut të jashtëzakonshëm në themelimin dhe rritjen e këtij institucioni.

Fjalën e hapjes të kësaj ceremonie

e mbajti komandanti i QPR-së, kolonel Altin Gjetaj, i cili falënderoi për bashkëpunimin e shkëlqyer të liderëve politik dhe ushtarakë, si dhe drejtuesit institucioneve të tjera FA-së. Në këtë aktivitet kolonel Gjetaj përmendi dhe disa prej arritjeve të institucionit, falë punës së drejtuesve dhe personelit civilo-ushtarak të tij, në këtë cikël 15-vjeçar pune të palodhur, duke bërë të mundur rritjen e cilësisë së shërbimit për aplikimin dhe marrjen e përgjigjeve dhe dokumentacionit të nevojshëm në kohë reale.

Ndërkohë që bëri me dije se këto shërbime tashmë janë pjesë e shërbimeve të ofruara në portalet elektronike zyrtare qeveritare për t'u njohur e përdorur nga shtetasit dhe institucionet shtetërore online, në çdo kohë. Përhëndetje dhe sugjerime për ecuri të mëtejshme, drejt standardeve të ushtrive aleate të Nato-s solli dhe komandanti i parë i QPR z. Zihni Goxhaj. Më tej përhëndeti dhe drejtoresha e personelit të Shtabit të Përgjithshëm, kolonela Irela Nebiaj, e cila në emër të zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, shprehu urimet më të mira në këtë 15-vjetor, si dhe mbështetjen për të arritur objektivat e standardizimit të një institucioni të rëndësishëm si QPR. Në emër të komandantëve të qendrës, z. Ilirian Balliu (ushtarak në pension), i cili falënderoi komandantin e qendrës, kolonel Altin Gjetaj, për punën e deritanishme dhe objektivat e së nesërme, si një qasje të re ndaj zhvillimit të kësaj qendre e cila është ngritur me shumë punë dhe mund.

Gjatë kësaj ceremonie, në shenjë mirënjohje për kontributin e tyre, në emër të Shtabit të Përgjithshëm u shpërndanë medalje për shërbime të veçanta me motivacionin: "Për profesionalizëm të lartë, përkushtim, besnikëri dhe arritje me tregues të lartë". Ceremonia u mbyll me një koktejl ku të pranishmit ndanë emocionet e punës së tyre në vite.

komandat, drejtoritë dhe komisionet e karrierës;

- Planifikon dhe organizon aktivitete promovuese dhe informuese për procesin e rekrutimit në FA;
- Kryen shërbime ndaj qytetarëve për pajisjen me vërtetime për kryerjen e Shërbimit Ushtarak Aktiv (SHDUA);
- Shërbim për përfitime suplementare të ushtarakëve në rezervë/lirim;

si dhe ndaj ushtarakëve në rezervë e lirim, për plotësimin e dokumentacionit për përfitimet suplementare, etj.;

- Vërtetim mbi kryerjen e Shërbimit të Detyrueshëm Ushtarak Aktiv (SHDUA);
- Shërbim për përfitime suplementare të ushtarakëve në rezervë/lirim;



INTERVISTË ME ISH-KOMANDANTIN E ARMËS SË TANKEVE, KOLONEL BUDJON ARAPI

Historia e suksesit 88-vjeçar të Armës së Tankeve

INTERVISTOI:
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE,
ANJEZA MUSOLLARI

Më 24 qershor 1928, me daljen e dekretit të mbretit Zog, krijohet Arma e Tankeve, një njësi mjaft e rëndësishme për ushtrinë shqiptare. Me një histori të gjatë sukcesi dhe me ushtarakë të përkushtuar, fuqia dhe kapaciteti i saj u rritën ndjeshëm, po ashtu dhe impakti që kjo armë pati në sytë e fqinjëve tanë, për këto dhe lavdinë e suksesit të kësaj arme, për gazetën "Ushtria" në këtë 88-vjetor, ish-komandanti i kësaj Arme, kolonel Budjon Arapi do sjellë emocionet dhe punën e palodhur të efektivëve në vite.

Kolonel Budjon Arapi, skënderbegas në vitet 1962-1966, Shkolla e Bashkuar 1967-1969, 1969-1979 në Zall Herr, komandant toge, komandant batalioni, 1979-1981 në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, 1981-1992 në BrT Laç, komisar BrT, 1992 në lirim, 1997-2002 komandant BrT në Zall Herr, 2002-2005, shef Shtabi i Reagimit të Shpejtë, 2005 në lirim.

Z. Budjon, kur u krijua arma e tankeve?

Më 1 prill 1946 u krijua formacioni i Armës së Tankeve.

Më 1 prill 1946 u krijua Kompania e Parë, në fillim me tanke të kapura të armikut, të prodhimit italian "Spali" dhe më vonë u pajis me teknikën moderne të kohës nga BS dhe RPK.

Arma e Tankeve përbëhet nga tanke, artileri vetëlëvizëse dhe transportues të blinduar dhe është organizuar në njësi, reparte e nënreparte.

Në prill 1948 u krijua Regjimenti i parë i tankeve "Vojo Kushi", ku përfshinte tipat: T-34 dhe AVL-76 m/m, të ardhura nga Bashkimi Sovjetik.

Brigada e Parë u krijua më 24 prill 1963 në përbërje të së cilës ishin tanket tip T-59 të prodhimit Kinez.

Në vitet '70, ushtria shqiptare kishte 10 brigada tankiste me nga 100 tanke të tipave T-59 (54), T-62, si dhe disa batalione autonome me drejtime të caktuara me tanke tip T-34, AVL-76 dhe 100 m/m. Ushtria shqiptare zotëronte dhe 3-4 batalione të mekanizuara me transportues të blinduar.

Ushtria jonë në fund të viteve '80 dispononte thuhetse 1 292 tanke e mjete të blinduara në arsenalin e saj.

Tanket ishin një fuqi shumë e madhe, e cila konsiderohej në artin ushtarak të atëhershëm, "Fuqia kryesore goditëse tokësore së bashku me këmbësorinë".

Përqendrimi i njësisve tankiste u bë kryesisht në zonat e desantimit ajror, si dimension i tretë i luftës që u krijua në atë kohë. Njësitë tankiste u vendosën kryesisht në Tiranë, Durrës, Fier, Lushnjë, Korçë, Shkodër, Gjiro-



kastër, pra buzë rrafshnaltave dhe fushave që kishte Shqipëria. Qëllimi kryesor i këtyre njësisve tankiste ishte të bllokonte desantin ajror. Në atë kohë desanti ajror përbënte një rrezik strategjik të luftës që mund të zhvillohej në atë kohë.

Tanket u përqendruan dhe drejtimet operative strategjike të planëzuara për të dhënë kundërgoditje, që planëzonte shteti shqiptar në rast agresioni nga toka ajri ose deti. Arma e tankeve ka qenë njësi elitare.

Cili ishte rrugëtimi i kësaj arme?

Gatishmëria dhe organizimi luftarak në atë kohë ishin të jashtëzakonshëm. Tanket, si armë moderne bashkëkohore kishin përparësi të rëndësishme e që ndoshta më parësore ishte mundësia e rritjes së gatishmërisë luftarake. Ishin marrë të gjitha masat, që nga përgatitja e efektivit, gatishmëria e armatimit e teknikës, sistemi i lajmërimit, njohja me rajonet e mundshme, ku do të kryhej detyra luftarake, përgatitja e pozicioneve etj. Përgatitja dhe gatishmëria luftarake

e njësisve tankiste kontrollohej çdo vit nga komanda Br, nga komanda e korpusit dhe MM nëpërmjet ekipit të Drejtorisë të Tankeve. Nga këto kontrole në vijimësi, Rreth 30% e tankeve të tjerë ishin në gjendje teknike e luftarake shumë të mirë. Veç kësaj, tankeve ruse apo kineze u kryeshin të gjitha shërbimet teknike të nevojshme sipas katalogëve, që shoqëroheshin nga fabrika. Konkretisht, SH.T-1 e SH.T-2, kryeshin në ofiçinat e brigadave të tankeve, të cilat dispononin

Kolonel Budjon Arapi, skënderbegas në vitet 1962-1966, Shkolla e Bashkuar 1967-1969, 1969-1979 në Zall Herr, komandant toge, komandant batalioni, 1979-1981 në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, 1981-1992 në BrT Laç, komisar BrT, 1992 në lirim, 1997-2002 komandant BrT në Zall Herr, 2002-2005, shef Shtabi i Reagimit të Shpejtë, 2005 në lirim.

pjesë xhenerike të veçanta, të reja. Ato ishin siguruar nga Uzina e Riparimit të tankeve në Tiranë. Kjo Uzinë ishte kompletuar me makineri dhe pjesë materiale të nevojshme, ku kryeshin edhe riparimet kapitale, deri dhe riparimin ose vendosjen e motorit të ri apo armatimit të ri. Tanku, kur dilte nga kjo uzinë, ishte i garantuar me parametrat e tankeve që dilnin nga fabrika.

Si vend i vogël dhe me ekonomi të dobët nuk kishim mundësi të blinim armë që kishin kosto të lartë financiare. Me prishjen e ish-BS si furnizuesi ynë me armë, Shqipëria vazhonte sërish të ishte e fuqishme në sasinë që dispononte. Si ishte kjo e mundur?

Për sipërfaqen që ka Shqipëria, ne ishim fuqia e parë për armë të blinduara. Ne, me kapacitetet që zotëronim, ishim të gatshëm të përballonim edhe agresionet më të fuqishme.

Si mirëmbaheshin tanket?

Ne i mbanim tanket në tunele. I përdornim vetëm kur bënim konservimin dy herë në vit. Pas konservimit të dytë i bënim një xhiro për të vënë në lëvizje të gjitha mekanizmat dhe i fusnim sërish brenda.



Ushtarët brenda në tank futeshin me papuçe jo me këpucë. Kaq shume kujdes tregoj për tankun. Kemi pasur një edukatë të jashtëzakonshme për mirëmbajtjen e teknikut. Ne për përgatitjen e kuadrove përdornim tanket mësimore jo tanket luftarakë.

Çfarë veprimesh operative keni kryer me tanket?

Ne kemi kryer stërvitje shumë të rëndësishme, ato që unë sjell në kujtesën time janë stërvitja e Kasharit në vitin 1974, ku u eksperimentuan për herë të parë tanket në luftim. Tanket luanin rolin kryesor në bllokimin e desantit ajror. Stërvitja e Sherbenikut, kushtet malore e bënë të vështirë dhe ajo që unë kam udhëhequr vetë si komandant ka qenë kriza e Kosovës.

Ne kemi qenë në grykën e Morinës, si mision kishim t'i tregonim serbit se ushtria shqiptare ishte një forcë e madhe dhe misioni i dytë ishte, se në rast provokacionesh nga Serbia do vepronim

menjëherë.

Rreth 20 tanke morën pjesë në atë stërvitje, si më e madhja deri atëherë, me një jehonë të tillë.

Ku i siguronin ato pjesë që nuk

prodhoheshin në vend?

Këto ishin punë dhe përkujdesje e shtetit, por me siguri që pjesa më e madhe vinte nga Kina. Çështja e ruajtjes dhe e shërbimeve teknike ishte detyrë

“Në vitet '70, ushtria shqiptare kishte 10 brigada tankiste me nga 100 tanke të tipave T-59 (54), T-62, si dhe disa batalione autonome me drejtime të caktuara me tanke tip T-34, AVL-76 dhe 100 m/m. Ushtria shqiptare zotëronte dhe 3-4 batalione të mekanizuara me transportues të blinduar. Ushtria jonë në fund të viteve '80 dispononte thuhetse 1 292 tanke e mjete të blinduara në arsenalin e saj. Tanket ishin një fuqi shumë e madhe, e cila konsiderohej në artin ushtarak të atëhershëm, “Fuqia kryesore goditëse tokësore së bashku me këmbësorinë”.

“Gatishmëria dhe organizmi luftarak në atë kohë ishin të jashtëzakonshëm. Tanket, si armë moderne bashkohore kishin përparësi të rëndësishme e që ndoshta më parësore ishte mundësia e rritjes së gatishmërisë luftarake. Ishin marrë të gjitha masat, që nga përgatitja e efektivit, gatishmëria e armatimit e teknikës, sistemi i lajmërimit, njohja me rajonet e mundshme, ku do të kryhej detyra luftarake, përgatitja e pozicioneve etj. Përgatitja dhe gatishmëria luftarake e njësisë tankiste kontrollohej çdo vit nga komanda Br, nga komanda e korpusit dhe MM nëpërmjet ekipit të Drejtorisë të Tankeve”.

parësore e MMP-ës, e cila nëpërmjet Drejtorisë së Tankeve, në çdo sekondë e kishte në pëllëmbë të dorës situatën dhe gatishmërinë luftarake të tankeve. Pas vitit 1971, në përgjithësi, njësitë tankiste u kompletuan me tanke të rinj kinez.

Ku përgatiteshin kuadrot e kësaj arme?

Në atë kohë kishim Shkollën e Bashkuar, e cila përgatiste ushtarakët e ardhshëm, më pas u krijua shkolla e tankeve, e inkuadruar në Shkollën e Bashkuar, ku përgatiteshin kuadrot tankiste, ndërsa shoferët tankistë, ekuipazhet, artiljerët, komandantët e tankeve përgatiteshin në njësitë tankiste. Brigada përgatiste ushtarët, shkolla përgatiste oficerët. Pra ne i kishim vetë kushtet për përgatitjen e kuadrove të armës së tankeve.

Kush ishin disa prej komandanteve të armës së tankeve?

Komandanti i parë ishte Myslym Keta, më pas erdhi Abaz Fejzo, Aleko Koka, Adnan Qatipi, një luftëtar i zoti e shumë të tjerë, të gjithë kuadro të përgatitur dhe të jashtëzakonshëm në drejtimin e detyrës të caktuar.

Mesazhi juaj për bashkudhëtarët në këtë armë që ka një histori 88-vjeçare?

Ju uroj të gjithëve jetë të gjatë dhe me vitalitetin që kjo armë na dha, besoj se do festojmë së bashku edhe shumë përvjetorë të tjerë me imazhin e forcës dhe dashurisë për këtë armë.



Një monografi historike në dritën e dokumenteve arkivorë të Nju Jorkut, nga studiuesi Halil Teodori

ALEKSANDRI I MADH

Në moshën 20-vjeçare, Aleksandri trashëgoi Mbretërinë e Ilirisë, shkruan Plutarku dhe kjo cilësohet jo vetëm në libër, por edhe në kopertinën e librit të studiuesit Halil Teodori.

Aleksandri i madh (356 - 323 para Erës së re) ishte i biri i Filipit II, mbretit të Maqedonisë dhe Olimbisë, princshë ilire, e bija e mbretit të Epirit Neoptolemi I.

Historishkruesit dhe rrëfimtaret janë përpjekur për ta mohuar origjinën shqiptare dhe rolin e heroit të Perandorisë Ilire, Aleksandrit të Madh.

Megjithëse janë shkruar shumë libra për luftën që bëri Aleksandri i Madh me mbretin e Persisë, e cila ka qenë një nga aktet kulmore të historisë, që tronditi gjithë botën në antikitet, janë zhdukur, dhe ata që kanë mbetur u janë tjetërsuar të gjitha të dhënat e dokumentuara. Një tjetërsim dashakeqës i është bërë historisë, dhe jo vetëm, për kombin shqiptar por edhe për gjithë botën nga antikiteti deri më sot.

Historia ka treguar se disa individë lindin të veçantë, ata kanë aftësi që të bëjnë të mundur ndryshimin e historisë. I tillë ishte edhe Aleksandri, një udhëheqës i madh me influencë në popull dhe së bashku me babanë e tij Filipin, kanë bërë ndryshim rrënjësor në kursin e historisë botërore.

Në më pak se dy shekuj ata ishin në gjendje të bënin bashkimin e mbretërve të Ilirisë në një federatë e emëruar "The United Kingdom of Iliria".

Ata krijuan një udhëheqje solide dhe një forcë ushtarake që nuk ishte parë ndonjëherë në histori. Mbas vdekjes së Aleksandrit të Madh, idealet për të cilat ai luftoi, luajtën një rol të madh në përhapjen e gjuhës së shkruar shqipe, kulturën dhe civilizimin Ilir, e cila, fatkeqësisht, sot nuk e ka këtë forcë dominuese.


Aleksandri i Madh mbetet edhe sot e kësaj dite, i famshëm. Në fushën ushtarake ai mbetet Gjeneralisimo. Ai renditet i pari ndër 10 ushtarakët e lashtësisë.

Vetëm një gjeni si ai mundi të avanconte me aq forca që ai dispononte.

Mbretëria Ilire, me qendër në Iliridë, u bë fuqia supreme gjatë periudhës që sundoi mbreti Filip II, (359-336) p.e.s. Çdo gjë e përgatitur prej tij, ishte një surprizë e jashtëzakonshme në formimin dhe konsolidimin e një ushtrie dhe e zhdërvjelltësisë politike në antikitetin e largët.

Shumë libra janë shkruar për njerëzit e famshëm të historisë, heronj legjendarë që i kanë vënë kohës emrin e tyre. Kështu ka ndodhur edhe me figurën e famshme historike, Aleksandri i Madh. Nga lashtësia e largët vijne shumë libra biografikë për Aleksandrin e Madh.

Historianët kanë shkruar, sipas këndvështrimit të tyre. Të gjithë men-



dojnë se biografia e tij ishte unike dhe secili mendonte se i kishte tejkaluar të gjitha veprat e autorëve të mëparshëm mbi jetën e Aleksandrit. Sigurisht autori Halil Teodori me studimin e tij voluminoz dhe referencat e shumta nuk pretendon se ka dhënë një përgjigje shteruese për historinë e Aleksandrit të madh, por ky libër është edhe një ftesë për të gjithë studiuesit për t'i

dhënë vendin që i takon.

Ka qindra studime në dispozicion që përmendin dhe tjetërsojnë shumë aspekte të jetës së Aleksandrit, së bashku me disa biografi akademike gjithëpërfshirëse të shtypura që krijojnë përfytyrime të gabuara si në detaje dhe në argumente.

"Përse vendosa të shkruaj një libër për Aleksandrin? Unë jam dardan,

-thotë autori, -dhe si shumë historianë të tjerë, jam i rritur i magjepsur nga ky personalitet i madh". Edhe Homeri, Enea që formëzoi Romën, Aleksandri i Madh, Kostandini i Madh, Skënderbeu, Nënë Tereza, ... ishin dardanë. Për këtë arsye, nuk munda t'i rezistojta dëshirës dhe pasionit, për t'u zhytur në burimet e lashta dhe moderne të jetës së tij, dhe për ta imagjinuar atë, duke vrapuar me kalin e tij Bucephalas nëpër fushat e Iliridës ose duke kaluar shkretëtirat dhe malet e Iranit, Indisë dhe Afganistanit. Ajo që është më e rëndësishme, doja të shkruaja një biografi të Aleksandrit, që është para së gjithash, një histori reale.

Halil Teodori është një studiues i rregullt, jo vetëm i historisë, por edhe i shumë fushave të tjera të përafërta, që jeton në Nju Jork, një nga anëtarët e rregullt të bibliotekës së Nju Jorkut, që ka shfrytëzuar materiale të shumta arkivore. Pra kemi të bëjmë me materiale të reja, shkrime e përkthime që autori i ka hulumtuar në SHBA, që e pasurojnë figurën e këtij udhëheqësi me famë botërore.

Autori ka shfrytëzuar përkthimet e Adrian Goldsworthy, Valerio Massimo, Peter Green, Frank L.Holt, etj.

Përkthimi i Valerio Massimo-s sipas autorit Teodori, kishte një tendencë për të futur në fillim të episodeve, ose paragrafëve të rinj, shënues të kohës, të tilla si "gjegj", "dergjegj" ose "kallim", dialekt i trevës dardane ku ato nuk shfaqeshin në greqishten e Plutarkut; rezultati ishte manipulues dhe i jepte një sens të rremë progresionit kronologjik.

Prandaj jam përpjekur të jap një interpretim që pasqyron më mirë logjikën e origjinalit të Plutarkut, shpjegon autori në fillim të librit.

Arritja e madhe letrare e Plutarkut ishin biografitë e tij për prijësit ushtarakë të kohës.

Plutarku paralajmëron lexuesit e tij që të mos presin rrëfim historik në shkallë të gjerë. "Bëmat e Aleksandrit nuk do të rrëfohen me hollësi. Unë jam duke shkruar jetën, jo historinë, dhe e vërteta është se shfrytëzimet më të shkëlqyera shpesh nuk na tregojnë asgjë nga virtytet apo veset e burrave që i kanë kryer ato, ndërsa nga ana tjetër një vërejtje rastësore ose një shaka mund të zbulojë shumë më tepër karakteri i njeriut, sesa betejat ku mijëra vdesin, vendosjet e mëdha të trupave ose rrethimet e qyteteve", -shkruan Plutarku.

Qëllimi i autorit nuk është të japë një mbulim të plotë ose të qëndrueshëm të një periudhe të veçantë historike, por për ne është shumë e rëndësishme të përqendrohemi në temën e tij biografike për t'i dhënë një material të tillë, si sfond, që lexuesit mund t'i duhet për ta kuptuar atë. Çdo e dhënë është marrë nga historianët antikë, studiuar me kujdes dhe vendosur në vendin ku duhet.

Përkushtimi i autorit ka pasur një qëllim në këtë libër, duke u mbështetur në historianë antik, të mund të përshkruaj sado pak jetën e Aleksandrit të Madh, Perandori Ilir, që pushtoi botën antike, për ta kthyer Aleksandrin e Madh, mbretin e Perandorisë Ilire, në vendin që i takon.

"Por njëkohësisht, në qoftë se diçka do mbetet pa thënë, kërkoj mirëkuptim nga lexuesit e mi. Unë jam duke shkruar për jetën e tij, kur e vërteta është se dokumentet që pretendohen se janë të shkëlqyera, shpesh nuk na tregojnë asgjë nga virtytet apo veset e personalitetëve, ndërsa nga ana tjetër ndodh që një moment rastësor, mund të zbulojë shumë më tepër për karakterin e tij, sesa betejat ku vdiqën mijëra, gjatë zhvendosjeve të mëdha të trupave ose rrethimeve të qyteteve.

Nuk mendoj se të gjitha thuhet për Aleksandrin e Madh, por jam ndalur në ato detaje të cilat ndriçojnë jetën e tij, për të krijuar një portret të jetës dhe veprës së tij, dhe kjo është mbi të gjitha detyrim, duke mos ua lënë të tjerëve shfrytëzimet dhe manipulimin e historisë së heroit tonë të madh pellazgo-ilir."

Kjo monografi voluminoze e dalë nga arkivat amerikane është një vlerë e shtuar e studimit të historisë sonë kombëtare dhe një libër me shumë vlera që i shtohet botimeve të autorit dibran me banim në Nju Jork, Halil Teodori.

SAKIP CAMI

ANJEZA MUSOLLARI,
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE

Po lundrojmë nëpër dallgët e shekullit të XXI, herë përplasemi fuqishëm me ajsbergët e padukshëm dhe herë vozitim mbi qetësinë e rreme të detit tinëzar.

Shpesh herë pyesim veten pse u gjetëm në këto ujëra?

Vetë ne, qeniet humane po tjetërsojmë gjithçka që kishte një emër, një formë, një vlerë.

Sipas Sokratit “çdo shoqëri e krijon modelin e njeriut sipas vetes së saj”. Shoqëria që lamë pas krijoi modelin e njeriut, në kushte e rrethana historike, me ndjesi e identitet të shtuar kombëtar. Është shoqëria, janë marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore që përcaktojnë shkallën kulturore e të sjelljes së individit.

Një shoqëri e përparuar dhe e moralshme krijon individë të kulturuar e të sjellshëm, raporti shoqëri-individ është reciprok. Në këtë raport, primar është interesi i përgjithshëm, që është bazë e jetës së shoqërisë dhe e çdo individit në veçanti. Vetëm nëpërmjet interesit të përgjithshëm, mund të plotësohen interesat personale dhe prirjet e veçanta të individit. Shoqëria dhe individit nuk janë fenomene të ndara.

“Në thelb, jemi qenie kolektive”, -thotë V. Gëte. Njerëzit i bashkon karakteri shoqëror i pronësisë, territori, ndërgjegjja kombëtare, gjuha, traditat, idetë dhe botëkuptimi se sa mentaliteti i një individit, i cili mbart në vetvete dhe prirje egoiste, individualiste, që po të shumohen shkojnë në dëm të jetës publike e të shoqërisë në tërësi. Në këtë raport përcaktuese mbeten marrëdhëniet në prodhim dhe karakteri i pronësisë.

Është shoqëria, janë marrëdhëniet në prodhim që përcaktojnë sjelljen e individit. Në të kundërt, shoqëria kthehet në anarki, siç është shoqëria e sotme shqiptare. Shoqëria, në bazë të ligjësisë objektive, nxjerr normat juridike dhe një sërë normash morale, universale të pranuar nga shoqëria. Individit nuk mund të merret i shkëputur nga marrëdhëniet shoqërore. Njeriu është i prirë të jetojë në shoqëri se është pjesë e saj dhe kjo e shtyn atë të zbatojë rregullat ligjore e morale.

Në përpunje me politikën e tij për përdorim të qëndrueshëm të pesticideve, Komisioni do të propozojë së shpejti, për herë të parë, një masë që do të ndjekë angazhimin e tij për të marrë parasysh konsideratat mjedisore globale kur vendoset për nivelet maksimale të mbetjeve në ushqim. Ushqimet e importuara që përbajnë mbetje të matshme të substancave të ndaluara, me kalimin e kohës, nuk duhet të tregtohen në BE. Kjo do të kontribuojë në një rreth të vërtetshëm dhe do të inkurajojë vendet e treta që gjithashtu të kufizojnë ose ndalojnë përdorimin e këtyre pesticideve, tashmë të ndaluara në BE. **Konkretisht, Komisioni do të konsultojë** së shpejti Shtetet Anëtare dhe vendet e treta për një masë që zvogëlon në zero mbetjeve të thiamethoksam dhe clothianidin, dy substanca të njohura se kontribuojnë ndjeshëm në rënie mbarë-botërore të pjalmuesve. Këto janë substanca që nuk miratohen më në BE. Kur të miratohet masa, ushqimet e importuara që përbajnë mbetje të matshme të këtyre dy substancave mund të mos tregtohen më në BE pas disa periudhave kalimtare.

Zëvendës-presidenti Ekzekutiv për Marrëveshjen e Gjelbër Europiane, Frans Timmermans, tha: "Ne njerëzit varem nga natyra. Për ajrin që thithim, për ujën që pimë, për ushqimin që hamë - për jetën. Edhe ekonomia jonë bazohet në natyrë. Krizat e klimës dhe biodiversitetit po kërcënojnë vetë themelin e jetës sonë në Tokë. Ne kemi bërë përparim në trajtimin e krizës klimatike dhe sot shtojmë dy ligje që përfaqësojnë një hap masiv përpara në trajtimin e ekocidit të afërt. Kur rivendosim natyrën, ne e lejojmë atë të vazhdojë të sigurojë ajër të pastër, ujë dhe ushqim, dhe e mundësojmë që të na mbrojnë nga më e keqja e krizës klimatike. Reduktimi i përdorimit të pesticideve gjithashtu ndihmon natyrën të rimëkëmbet dhe mbrojtjen që punojnë me këto kimikate."

Komisioneri për Mjedisin, Oqeanet dhe Peshkimin, Virginijus Sinkevicius, tha: "Europianët janë të qartë: ata duan që BE të veprojë për natyrën dhe ta kthejë atë në jetën e tyre. Shkencëtarët janë të qartë: nuk ka kohë për të humbur, dritarja po mbyllet. Dhe i qartë është edhe rasti i biznesit: çdo euro e shpenzuar për restaurim do të na sjellë të paktën tetë në këmbim. Kjo është

ajo që ky propozim historik ka të bëjë, duke rivendosur biodiversitetin dhe ekosistemet në mënyrë që ne të mund të jetojmë dhe të lulëzojmë së bashku me natyrën. Është një ligj për të gjithë njerëzit në Europë dhe për brezat që do të vijnë, për një planet të shëndetshëm dhe një ekonomi të shëndetshme. Është i pari i këtij lloji globalisht dhe shpresojmë se mund të frymëzojë angazhim të lartë ndërkombëtar për mbrojtjen e biodiversitetit në COP15 të ardhshëm."

Komisionerja për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore, Stella Kyriakides, theksoi: "Është koha për të ndryshuar kursin se si i përdorim pesticidet në BE. Bëhet fjalë për shëndetin e qytetarëve tanë dhe planetit tonë. Nëpërmjet këtij propozimi, ne po përbushim pritshmëritë e qytetarëve tanë dhe angazhimet tona në strategjinë "Farm to Fork", për të ndërtuar një sistem më të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm të prodhimit të ushqimit. Ne duhet të reduktojmë përdorimin e pesticideve kimike për të mbrojtur tokën, ajrin dhe ushqimin tonë, dhe në fund të fundit shëndetin e qytetarëve tanë. Për herë të parë, ne do të ndalojmë përdorimin e pesticideve të pesticideve në kopshtet publike dhe këndet e lojërave, duke siguruar që të gjithë të jemi shumë më pak të ekspozuar në jetën tonë të përditshme. Politika e Përbashkët Bujqësore do të mbështesë financiarisht fermerët për të mbuluar të gjitha kostot e rregullave të reja për një periudhë 5-vjeçare. Askush nuk do të mbetet pas."

Të dy propozimet do të diskutohen nga Parlamenti Europian dhe Këshilli, në përpunje me procedurën e zakonshme legjislative.

Pas miratimit, ndikimi në terren do të jetë gradual: masat për restaurimin e natyrës do të vendosen deri në vitin 2030, ndërsa objektivat e pesticideve duhet të arrihen deri në vitin 2030. Si e tillë, nuk ka asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me ndikimet e menjëhershme të luftës ruse të agresionit kundër Ukrainës. Këto propozime do të forcojnë qëndrueshmërinë dhe sigurinë ushqimore të Europës në afat të mesëm, pasi ndërsa popullatat e pjalmuesve do të bëhen më të shëndetshme dhe më të bollshme, erozioni i tokës do të ulët dhe mbajtja e ujit do të përmirësohet dhe mjedisi ynë natyror do të bëhet më i pastër dhe gjithnjë e më pa toksikë. Ai gjithashtu do të reduktojë varësinë e fermerëve nga inputet e shtrenjta, të tilla si pesticidet kimike, duke mbështetur ushqimin e përbalueshëm për të gjithë europianët.

Asambleja Dixhitale 2022: Një vështrim më i afërt në të ardhmen dixhitale



Në Asambleshë Dixhitale, të mbajtur javën e tretë të qershorit në Toulouse, Komisioni Europian dhe Presidenca Franceze e Këshillit të Bashkimit Europian kanë organizuar një sesion mbi mbështetjen e vazhdueshme për sektorin dixhital të Ukrainës. Ky sesion u shënuar fillimisht në një qendër të dedikuar donacionesh të teknologjisë dixhitale për Ukrainën. Për më tepër, ministrat nga Shtetet Anëtare kanë nënshkruar një deklaratë mbi tranzicionin klimatik për të reduktuar gjurmën mjedisore të sektorit dixhital dhe diskutuan veprime konkrete për të forcur rolin udhëheqës të BE-së në teknologjitë zhytëse. Shtetet anëtare ranë dakord të vepronin së bashku në këto dy fusha thelbësore dhe të kërkojnë mbështetjen e Komisionit për të përcaktuar objektiva specifike për sektorin e TIK-ut në tranzicionin e gjelbër dhe për të zhvilluar teknologji zhytëse në përpunje me vlerat themelore europiane. Edicioni i këtij viti i Asamblesë Dixhitale iu kushtua gjithashtu objektiveve të vitit 2030 të përcaktuara në Komunikimin e Dekadës Dixhitale të Komisionit, duke përfshirë aftësitë dixhitale, infrastrukturat dixhitale, zinxhirin e vlerave dixhitale dhe transformimin dixhital. Për shembull, janë marrë sugjerime për veprime për të arritur objektivin për aftësitë, veçanërisht për mënyrën se si të arrihen 20 milionë specialistë të TIK-ut deri në vitin 2030, konvergjenca gjinore, si dhe rritja e numrit të ekspertëve sektorialë që përdorin teknologji të avancuara dixhitale.

Thierry Breton, Komisioneri për Tregun e Brendshëm, tha: "Është më shumë se kurrë e rëndësishme ta mbajmë Ukrainën sa më afër tregut të vetëm të BE-së. Në muajt e fundit, Bashkimi Europian ka treguar tashmë solidaritet të fortë me Ukrainën. Megjithatë, nevojiten ende përpjekje masive për të rindërtuar vendin. Ofrimi i koordinimit dhe strukturës në nivel BE do të na ndihmojë të sigurojmë mbështetje të situar dhe të vazhdueshme për sektorin dixhital të Ukrainës." Bruno Le Maire, ministër i Ekonomisë dhe Financave i Francës, tha: "Asambleja Dixhitale shënon përfundimin e Presidencës Franceze të Këshillit të Bashkimit Europian. Në 6 muaj, Presidenca Franceze arriti piketa të mëdha, me miratimin e Aktit të Tregjeve

Dixhitale dhe aktit të Shërbimeve Dixhitale për t'i bërë platformat dixhitale të përgjegjshme, si dhe me iniciativën e tilla si "Scale Up Europe", për të forcur ekosistemet inovative të BE-së. Jam krenar të shoh se gjatë kësaj ngjarjeje, Shtetet Anëtare ranë dakord të përshpejtojnë më tej tranzicionin e gjelbër dhe dixhital dhe të forcojnë aftësitë e BE-së në teknologjitë zhytëse. Ata gjithashtu arritën në përfundim për domosdoshmërinë për të shkuar më tej në sovranitetin e cloud dhe pronësinë e të dhënave. Kjo është thelbësore nëse BE-ja dëshiron të arrijë objektivat e saj dixhitale për vitin 2030. Unë e di që Republika Çeke do t'i vazhdojë këto përpjekje dhe u uroj atyre çdo të mirë për Presidencën e ardhshme."

E ardhmja e internetit: Forcimi i aftësive teknologjike të BE-së

Gjatë këtij sesiioni kushtuar të ardhmes së internetit, përfaqësuesit e BE-së, ministrat dhe palët e interesuara riazfirmuan angazhimin e tyre për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut në internet dhe në mbarë botën dixhitale. Pjesëmarrësit kërkuar, ndër të tjera, të zhvillojnë më tej industrinë europiane të gjysmëpërcuesve, nëpërmjet Aktit Europian të Çipave, në mënyrë që të arrihet 20% e pjesës së tregut global deri në vitin 2030; për të investuar në teknologjitë dixhitale; si dhe për të zhvilluar teknologji gjithëpërfshirëse në përpunje me vlerat, të drejtat themelore dhe rregulloret europiane.


Drejti një tranzicioni të suksesshëm të gjelbër dhe dixhital në Europë

Tranzicioni dixhital dhe një përdorim më i zgjuar dhe më i gjelbër i teknologjive do të ndihmojë BE-në të reduktojë emetimet neto të gazeve serrë me të paktën 55% deri në vitin 2030 dhe ta bëjë Europën kontinentin e parë neutral ndaj klimës deri në vitin 2050, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Gjelbër Europiane dhe Ligji Europian për Klimën. Paralelisht me Asambleshë Dixhitale të këtij viti, Ministrat nga Shtetet Anëtare diskutuan veprime konkrete për të reduktuar gjurmën mjedisore të sektorit dixhital, me objektivin për të përdorur potencialin e plotë të teknologjive për ta shndërruar atë në një levë për tranzicionin mjedisor, si dhe për të monitoruar dhe optimizuar kostot mjedisore të sektorit dixhital.

SYTË SEKRET NË HAPËSIRË

Përdorimi i satelitëve nga ushtria

Inteligjenca, komunikimi dhe lëvizshmëria lejojnë që edhe një ushtri jo shumë e fuqishme të fitojë betejë. E gjithë kjo është e pamundur sot pa satelitë. Është e vështirë të imagjinohet marrja e informacionit për pajisjet e armikut pa fotografi nga hapësira; lëvizja nëpër terrene të panjohura pa një navigator; dhe koordinim i mirë ndërmjet njësive pa komunikim. Për të përmbushur këto nevoja, ushtria përdor tre lloje të anijeve kozmike: mbikëqyrje, komunikim dhe navigacion. Për më shumë detaje, më poshtë pasqyrohen disa observime të marra nga "The Universe.Space.Tech".



Vëzhgimi i armikut është një nga detyrat kryesore të satelitëve në luftë. Burimi: www.themoscowtimes.com

Hakerat kundër satelitëve

Lufta e plotë e Rusisë kundër Ukrainës ka zbuluar një dobësi të mundshme të infrastrukturës hapësinore. Në prag të pushtimit, Moskua kreu një sulm masiv kibernetik në rrjetet satelitore. Hakerat u përpoqën të ndërhyjnë në punën e anijeve kozmike që transmetojnë komanda tek dronët ushtarakë ukrainas.

Sulmi në hapësirën kibernetike është kryer jo vetëm ndaj Ukrainës. Të njëjtën ditë, Elon Musk raportoi një përpjekje të Rusisë për të bllokuar sinjalet "Starlink" pranë kufirit ruso-ukrainas dhe ekspertët regjistruan një rritje të ndërhyrjes GPS në rajonin e Ukrainës. Keqbehërsit hakuan dhe mbyllën rrjetin e internetit satelitor KA-SAT të kompanisë amerikane Viasat, e cila ofronte shërbime për shumë agjenci qeveritare të Ukrainës dhe agjenci qeveritare në vendet fqinje.



Sateliti KA-SAT. www.viasat.com

Si rezultat, Shtetet e Bashkuara filluan të rishtrukturojnë plotësisht sistemin e tyre të sigurisë në hapësirë në tre fusha: rritja e qëndrueshmërisë ndaj plasaritjes së softuerit, integrimi i operatorëve tregtarë në këto përpjekje dhe krijimi i Forcave Hapësinore Aleate.

"Mjegulla e luftës"

Për të pasur sukses, ushtria duhet të ketë informacion të besueshëm për armikun dhe të koordinojë mirë veprimet e njësive të veta. Në të njëjtën kohë, të dyja palët ndërlyftuese do të bëjnë

çmos për të fshehur veprimet e tyre: të maskohen, të kryejnë manovra mashtruese, thjesht të fshihen në mes të fushës. Ushtria ka një term të veçantë për këtë: "mjegull luftime".

Në kushte të tilla, është e vështirë të verifikohet shpejt dhe me efikasitet informacioni. Këtu dalin në pah satelitët e zbulimit. Ata na lejojnë të marrim informacione të besueshme për vendndodhjen e armikut dhe lëvizjen e tij. Një togë armike mund të qëllohet, një dron ose një avion mund të rrëzohet, por është e vështirë të shkatërrosh një objekt në orbitë. Armët kundër satelitit janë ende vetëm në fazën eksperimentale dhe përdorimi i tyre është një thikë me dy tehe. Pas goditjes, sasia e mbeturinave në orbitë do të rritet në mënyrë dramatike dhe rrënojat e satelitit të shkatërruar do të përbëjnë një kërcënim për infrastrukturën hapësinore të vetë sulmuesit.

Kjo u demonstrua qartë nga Rusia, e cila përdori armë anti-satelitore vitin e kaluar. Pas goditjes së anijes së vjetër sovjetike, sasia e mbeturinave në orbitë u rrit ndjeshëm, duke paraqitur një kërcënim serioz për Stacionin Ndërkombëtar të Hapësirës.

Satelitë me rreze optike

Satelitët e zbulimit vijnë në disa lloje në varësi të gamës në të cilën ata veprojnë. Opsioni më i thjeshtë është diapazoni optik. Kjo është ajo që ne do të shihnim me sytë tanë nëse do të ishim ulur në një anije kozmike me një teleskop.



Satelitët e vëzhgimit Maxar. Burimi: Maxar Technologies

Rezolucioni i imazheve të satelitëve në intervalin optik tani është disa dhjetëra centimetra. Kjo është e mjaftueshme për të dalluar tanket nga kamionët dhe për të numëruar numrin e tyre. Për shkak të kësaj, shtabi është në dijeni të akumulimit të pajisjeve dhe trupave të armikut. Nga orbita mund të shihni edhe trupat e të vranëve, gjë që bëri të mundur regjistrimin dhe vërtetimin e krimeve të ushtrisë ruse në Bucha, Irpen dhe qytete dhe fshatra të tjera të Ukrainës.

Satelitët "Maxar" janë të këtij lloji. Ata ofrojnë vazhdimisht fotografi sensacionale gjatë gjithë luftës ruso-ukrainase. Më parë, vetëm ushtria kishte akses në pajisje të tilla, siç ilustron nga KH-11 (Keyhole), i cili u lëshua nga Shtetet e Bashkuara gjatë Luftës së Ftohtë. Tani fotografitë e këtij lloji janë të disponueshme për të gjithë.

Pajisjet orbitale të shikimit të natës

Sidoqoftë, diapazoni optik ka të metat e veta. Kjo ju lejon të shihni diçka në Tokë vetëm gjatë ditës dhe në mungesë të reve ose tymit. Ky problem zgjidhet pjesërisht nga imazhet infra të kuqe. Ju mund të shihni të gjithë trupat e nxehtë në foto të tilla, që do të thotë se satelitë të tillë ju lejojnë të shihni objekte të ngrohta edhe gjatë natës.

Rrezatimi i trupit të njeriut është në kufirin e ndjeshmërisë së "pajisjeve orbitale të shikimit të natës". Situata është krejtësisht e ndryshme me motorët e tankeve dhe mjeteve të tjera të blinduara luftarake. Ato duken qartë dhe kjo e bën të pakuptimtë çdo ndërprerje gjatë lëvizjes së kolonave gjatë natës.



Imazhi satelitor me rreze infra të kuqe i sipërfaqes së Tokës. Burimi: Eos.com


Edhe më mirë në rrezen infra të kuqe mund të shihni aeroplanë, helikopterë dhe raketa lundrimi. Motorët e tyre nxehen deri në qindra e mijëra gradë Celsius, kështu që ndonjëherë mund të shihen edhe përmes reve të lehta. Në veçanti, kështu mund të gjurmohen Iskanderët dhe Kalibrat rusë. Askush nuk i "kap" ata në afim. Në vend të kësaj, sateliti skanon një rrip sipërfaqje qindra kilometra të gjerë dhe "i sheh" ato në nisje.

Satelitët radarë

Retë thithin në mënyrë efektive rrezatimin, kështu që ato janë një pengesë e vërtetë për satelitët. Por ky nuk është problem për rrezatimin e drejtuar. Të tilla janë bazat e funksionimit të satelitëve të radarëve.

Sisteme të tilla janë shumë më komplekse se kamerat optike dhe ato infra të kuqe. Së pari, ju duhet të krijoni valë radio duke përdorur një transmetues dhe një sistem drejtimi. Rrezja më pas fluturon në Tokë, kalon nëpër një shtresë resh, kërcen nga sipërfaqja, pastaj kthehet dhe merret nga antena.

Disavantazhi i radarëve është ndjeshmëria shumë e ulët se sistemet optike. Më parë, ishte e pamundur të merrej një imazh i qartë i sipërfaqes me ndihmën e valëve të radios të reflektuara. Më e shumta që mund të shihej ishin drejtimet nga vinte jehona e fortë ose disa turbullira.




Imazhi i radarit të kryqëzorit të raketave "Moskva". Burimi: www.navalnews.com

Sot, pajisje të tilla si "Sentinel" përdorin radarë me hapje të sintetizuar. Ndërsa lëvizin në orbitë, ata "kujtojnë" gjurmët e sinjalit çdo sekondë dhe më pas i bashkojnë, duke krijuar një pamje tredimensionale nga e cila mund të mësoni edhe materialin e objekteve të caktuara. Por imazhe të tilla kanë edhe një rezolucion të matur në metra, që është shumë larg cilësisë së imazheve optike.

A është e mundur të fshihesh nga vëzhgimi orbital?

Ka satelitë të tjerë, disi më ekzotikë vëzhgimi. Për shembull, monitorët "HawkEye 360" përpiqen të bllokojnë sinjalet e sistemit të pozicionimit global. Këto të dhëna ndihmuan shumë ushtrinë ukrainase për të identifikuar luftën elektronike ruse.

Mjetet e mbikëqyrjes së hapësirës nuk janë të gjithëfuqishme. Pavarësisht miteve të zakonshme, satelitët nuk janë në gjendje të njohin fytyrat e ushtarëve të armikut ose të lexojnë dokumente sekrete. Por zakonisht kjo nuk është e nevojshme. Gjithsesi, lëvizja e njerëzve dhe e teknologjisë gjurmohet më mirë tani se në ndonjë nga luftërat e kaluara.



Harta e shumta të luftës në Ukrainë që kundërshtojnë njëra-tjetrën për shkak të mungesës së të dhënave janë një shembull i mirë i "mjegullës së luftës". Burimi: www.moviesonline.ca

Tetë mësim – disa të vjetra, disa të reja – që bota po i mëson (ose po i rimëson) nga lufta në Ukrainë.

Së pari, frenimi bërthamor funksionon, por më shumë varet nga raporti relativ, sesa nga kapacitetet absolute. Perëndimi është frenuar, por vetëm deri në një pikë. Kërcënimet e Putinit i kanë penguar qeveritë perëndimore të dërgojnë në Ukrainë trupa, por nuk i kanë penguar të dërgojnë pajisje.

JOSEPH SAMUEL NYE JR.

Kur presidenti rus Vladimir Putin urdhëroi pushtimin e Ukrainës, më 24 shkurt, ai parashikoi një kapje të shpejtë të Kievit dhe një ndryshim të qeverisë - një operacion analog me ndërhyrjet sovjetike në Budapest në 1956 dhe Pragë në 1968. Por nuk qe e thënë. Lufta është ende e ndezur dhe askush nuk e di se kur e si do të përfundojë.

Ndërsa disa vëzhgues kanë nxitur një armëpushim sa më të shpejtë të jetë e mundur, të tjerë kanë theksuar rëndësinë e ndëshkimit të agresionit rus. Sidoqoftë, rezultati do të përcaktohet nga faktet në terren.

Duke qenë se është shumë herët të merret me mend se kur do të përfundojë lufta, nxjerrja e përfundimeve është, padyshim, e parakohshme. Për shembull, argumentet se epoka e luftës së tankeve ka mbaruar, janë hedhur poshtë, pasi beteja është zhvendosur nga periferitë veriore të Kievit në fushat lindore të Donbasit.

Por edhe në këtë fazë të hershme, dalin të paktën tetë mësim – disa të vjetra, disa të reja – që bota po i mëson (ose po i rimëson) nga lufta në Ukrainë.

Së pari, frenimi bërthamor funksionon, por më shumë varet nga raporti relativ, sesa nga kapacitetet absolute. Perëndimi është frenuar, por vetëm deri në një pikë. Kërcënimet e Putinit i kanë penguar qeveritë perëndimore të dërgojnë në Ukrainë trupa, por nuk i kanë penguar të dërgojnë pajisje.

Ky rezultat nuk pasqyron ndonjë kapacitet superior bërthamor rus. Përkundrazi, ai pasqyron hendekun midis përkufizimit të Putinit për Ukrainën si një interes jetik kombëtar dhe përkufizimit të Perëndimit për Ukrainën si një interes i rëndësishëm, por më pak jetik.

Së dyti, ndërvarësia ekonomike nuk e pengon luftën. Ndërsa ky mësim dikur njihej gjerësisht – veçanërisht pasi shpërtheu Lufta e Parë Botërore mes partnerëve kryesorë tregtarë në botë – ai u shpërfill nga politikëbërësit gjermanë, si për shembull, ish-kancelari gjerman Gerhard Schröder.

Qeveria e tij rriti importet dhe varësinë e Gjermanisë nga nafta dhe gazi rus, ndoshta duke shpresuar se prishja e lidhjeve tregtare do të ishte shumë e kushtueshme për secilën palë. Por, edhe pse ndërvarësia ekonomike mund të rrisë kostot e luftës, ajo dukshëm nuk e pengon atë.

Së treti, ndërvarësia e pabarabartë ekonomike mund të përdoret si armë nga pala më pak e varur, por kur fuqitë janë simetrike, ndërvarësia ka pak ndikim. Rusia varet nga të ardhurat nga eksportet e saj të energjisë për të financuar luftën e saj, por Europa është shumë e varur nga energjia ruse për ta ndërprerë atë plotësisht.

Ndërvarësia e energjisë është afërsisht simetrike. Ndërkohë, në botën e financave, Rusia është më e ndjeshme ndaj sanksioneve perëndimore, sepse këto mund ta dëmtojnë më shumë me kalimin e kohës.



Së katërti, ndërsa sanksionet mund të rrisin kostot për agresorët, ato nuk përcaktojnë rezultatet afatshkurtër. Drejtori i CIA-s, Uilliam Bërns (ish-ambasador i SHBA-së në Rusi) thuhet se u takua me Putinin nëntorin e vit të kaluar dhe se e paralajmëroi atë, pa dobi, se një pushtim do të shkaktoje sanksione.

Putini mund ta ketë vënë në dyshim unitetin e Perëndimit për të vënë dhe për të mbajtur sanksionet. (Nga ana tjetër, presidenti kinez Xi Jinping i ka ofruar vetëm mbështetje të kufizuar Putinit, pavarësisht se ka shpallur një miqësi “të pakufizime” me Rusinë, ndoshta për shkak të shqetësimeve të tij se Kina mund të përfshihej nga SHBA-të në sanksione menjëherë pas Rosisë.)

Së pesti, lufta e informacionit bën diferencën. Siç theksoi Xhon Arkuila (akademik në marrëdhëniet ndërkombëtare, analist në Korporatën amerikane RAND) dy dhjetëvjeçarë më parë, rezultatet e luftës moderne nuk varen vetëm se ushtria e kujt fiton, por edhe nga “përralla e kujt fiton”.

Publikimi i kujdesshëm i të dhënave të inteligjencës nga ana e Amerikës në lidhje me planet ushtarake të Rosisë, rezultoi mjaft efektiv në “para-demaskimin” e përrallave të Putinit në Europë dhe kontribuoi shumë në solidaritetin perëndimor kur pushtimi ndodhi siç ishte parashikuar.

Së gjashti, fuqia materiale dhe fuqia morale kanë rëndësi. Ndërsa kërcënimet e eklipsion bindjen në një afat të afërt, fuqia morale mund të bëjë ndryshimin me kalimin e kohës. Fuqi e mençur është aftësia për të gërshetuar fuqinë materiale me fuqinë morale, në mënyrë

që ato të përforcojnë njëra-tjetrën, jo të kundërshtojnë njëra-tjetrën.

Putini dështoi ta bëjë këtë.

Brutaliteti i Rosisë në Ukrainë krijoi një neveri të tillë, sa që Gjermania vendosi përfundimisht të pezullojë gazsjellësin “Nord Stream 2” – një rezultat që presioni i SHBA-së gjatë disa viteve kishte dështuar për ta arritur.

Në të kundërt, presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy, një ish-aktor, përdori aftësitë e tij dramatike profesionalisht të mprehta, për të paraqitur një portret tërheqës të vendit të tij, duke siguruar jo vetëm simpatinë, por edhe pajisjet ushtarake, të cilat janë thelbësore për fuqinë materiale.

Së shtati, aftësia kibernetike nuk është një plumb argjendi. Rusia kishte përdorur armë kibernetike për të ndërhyrë në rrjetin elektrik të Ukrainës, të paktën që nga viti 2015 dhe shumë analistë parashikuan një sulm kibernetik rrufë kundër infrastrukturës dhe qeverisë së Ukrainës në fillim të pushtimit.

Megjithatë, edhe pse thuhet se ka pasur shumë sulme kibernetike gjatë luftës, asnjë prej tyre nuk ka përcaktuar rezultate me efekt të gjerë. Kur rrjeti satelitor Viasat u hakërua, Zelenskyy vazhdoi të komunikonte me audiencën botërore përmes shumë satelitëve të vegjël të ofruar nga “Starlink”.

Për më tepër, me trajnim dhe përvojë, mbrojtja kibernetike e Ukrainës është përmirësuar. Sapo lufta kishte filluar, armët kinetike siguruan vlerësime më të mëdha në

kohë, saktësi dhe vlerësim dëmtimesh për komandantët, sesa armët kibernetike. Me armët kibernetike, ju nuk e dini gjithmonë nëse një sulm ka pasur sukses apo ka mbetur për t’u rimbështetur. Ndryshe është me eksplozivët, ku ju mund të shihni ndikimin dhe të vlerësoni më lehtë dëmtimet.

Më në fund, mësimi më i rëndësishëm është gjithashtu një nga më të vjetrit: lufta është e paparashikueshme. Premtimi për një luftë të shkurtër është jashtëzakonisht joshës. Por, siç shkroi Shekspiri më shumë se katër shekuj më parë, është e rrezikshme për një lider të ulërijë për të bërë kërdrinë kur lëshon qentë e luftës.

Në gusht të vitit 1914, udhëheqësit europianë prisnin që trupat “të ishin në shtëpi deri në Krishtlindje”. Por, në vend të kësaj, ata u zhytën në katër vjet luftë dhe katër nga ata udhëheqës humbën fronet e tyre.

Menjëherë pas pushtimit të Irakut nga Amerika në vitin 2003, shumë personalitete në Uashington parashikuan një shëtitje të lehtë (“Misioni u krye” lexohej në flamurin e anijes luftarake amerikane në maj të atij viti), por përpjekjet ngecën në baltë për vite me radhë.

Tani është Putini ai që ka lëshuar qentë e luftës, por ata ende mund të kthehen kundër tij.

**Joseph S. Nye, Jr., është profesor në Universitetin e Harvardit, ish-Ndihmës Sekretar i Mbrojtjes i SHBA-së. Artikulli është shpërndarë nga*

Project Syndicate (www.project-syndicate.org).

Përshtatur nga Zeno Jahaj



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Një përvojë pune që heshti nga reforma në ushtri


Botimi i Fjalorit të Enciklopedisë Ushtarake Shqiptare (FEUSH) është përpjekja e parë dhe e madhe tërësore e grumbullimit dhe sistemimit të njohurive në fushën ushtarake dhe e paraqitjes së tyre në një formë të përmbledhur. Kjo vepër është një botim informativ shkencor për problemet e historisë e të teorisë ushtarake, të teknikës e armatimit, të gjeografisë ushtarake dhe të jetëshkrimit të luftëtarëve të shquar të popullit shqiptar në fushën ushtarake e të luftërave të tij për liri, pavarësi e demokraci. Në fjalor përfshihen zëra për tematikën teoriko-ushtarake, për gjendjen e doktrinës dhe të shkencës ushtarake shqiptare, për probleme të ndërtimit dhe të organizimit të FA-së në etapa të ndryshme historike etj.

Fjalori nisi punë në vitin 1985 sipas një urdhri të Ministrisë së Mbrojtjes dhe u punua deri në vitin 1992 me rreth 450 autorë e bashkautorë, ku funksionuan 17 redaksi të fushave me 3-6 anëtarë secila, redaksia operative me 20 anëtarë dhe redaksia e përgjithshme me 12 anëtarë. Drejtimi dhe trajtimi shkencor i punës së këtij grupi të madh autorësh e redaksish u krye nga Dega e Terminologjisë dhe Enciklopedisë Ushtarake (TEU) në Akademinë Ushtarake, e cila pas vitit 1992 për shkak të reformës ushtarake, dega e TEU-t u shkri pa u përfunduar fjalori dhe, bashkë me të, heshtën të gjitha redaksitë e ngritura së toku me autorët e bashkautorët, të cilët u larguan dhe iu ndërpre në gjitha marrëdhëniet zyrtare e financiare. Mbeti vetëm një punonjës shkencor për të kryer punën e sekretarit shkencor në Qendrën e Enciklopedisë Shqiptare në Akademinë e Shkencave për Fushën e Mbrojtjes, të Rendit dhe të Historisë Ushtarake të "Fjalorit Enciklopedik Shqiptar". Në janar 2007 dhe ky punonjës shkencor u nxor në pension dhe funksioni organik i Degës së TEU-t u shkri përfundimisht. Nuk u mor parasysh edhe vlerësimi që bëri Agjencia e Terminologjisë Ushtarake të NATO-s në vitin 2000, mbi përvojën e së cilës u krijuan qendrat e terminologjisë ushtarake në të gjitha shtetet partnere.

Pas 35 vitesh doli në dritë fjalori ushtarak

Fjalori në historiografinë e Ushtrisë Shqiptare është fryt i mendimit shkencor të një grupi të madh autorësh e bashkautorësh nga të gjitha fushat dhe specialitetet ushtarake. Kjo vepër me një vëllim rreth 5 200 zëra enciklopedik, ndër të cilët mbi 1000 zëra jetëshkrimorë, së bashku me 250 ilustrimet përkatëse, mbështetet në parime metodologjike shkencore. Për hartimin e zërave nga autorët dhe për diskutimin e materialeve në grupet e punës dhe në redaksitë e fushave, kuadrot e ngarkuar me këto detyra, para vitit 1992 shkëputeshin nga puna dy muaj në vit. Për pedagogët e Akademisë Ushtarake dhe të shkollave të tjera ushtarake kjo

FEUSH, një vepër e vyer në shërbim të historisë së FARSH



detyrë u llogaritej në ngarkesën e punës mësimore e shkencore. Në ndihmë të redaksive u caktuan kuadro aktivë e rezervistë dhe pensionistë të cilësuar, që u trajtuan financiarisht sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave. Zërat e hartuar nga autorët e bashkautorët u diskutuan në redaksitë e fushave dhe, pasi u shqyrtuan në redaksinë operative për saktësinë e të dhënave dhe nivelin cilësor, u rikthyen për plotësimet dhe përmirësimet e nevojshme.

Prof. Hasan Çipuri me materialet e lëna në mes, së bashku me kolegun dr. shkencash Kudret Mita, vijuan punën për rishikimin e ripunimin e zërave të planifikuar dhe për përfundimin e fjalorit. Me vetëdijen e plotë për vështirësitë e pareshtura me të cilat u ndeshën, punuan në rrugën e stërmundimshme të hartimit të fjalorit. Shtysën kryesore për të vijuar përgatitjen dhe botimin e fjalorit e kishin një detyrim moral ndaj grupit të madh të kolegëve dhe bashkëpunëtorëve, por dhe të përpjekjeve nismëtare për paraqitjen përgjithësuere të mendimit teoriko-ushtarak shqiptar. Përmbushja e këtij detyrimi parakuptonte një përkushtim ndaj punës disavjeçare për rishikimin, ripunimin, përditësimin, saktësimin, redaktimin dhe harmonizimin e pjesëve përbërëse të zërave në përshtatje me kërkesat thelbësore të paraqitjes enciklopedike.

Autorët

Prof. Hasan Çipuri (kolonel në pension) në vitin 2017 ndërroi jetë dhe puna ngeli në dorën e vetme të Doktorit të Shkencave, Kudret Mita (kolonel në pension). Vepra për autor recensioni pati prof. Kostaq Karolin (gjeneralmajor në pension) dhe Xhemil Çelaj (kolonel në pension), i cili ndërroi jetë në vitin 2021. Libri u fut për shtyp në Prishtinë në vitin 2020 dhe doli nga shtypi në vitin 2022

të botuar nga Shtëpia Botuese "IVA BOGDANI".

Tematika e fjalorit është historia ushtarake shqiptare

Në fjalor një vend të dukshëm zë tematika historiko-ushtarake, e cila trajton historinë e luftërave dhe të artit ushtarak shqiptar, të filluar nga lashtësia e deri në vitin 2010. Një rëndësi të veçantë iu është kushtuar luftimeve e kryengritjeve ilire kundër romakëve e maqedonasve, betejave historike të popullit shqiptar kundër Perandorisë Osmane nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, veprimtarisë ushtarake të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe figurave kryesore historike, kryengritjeve të mëdha kundër osmane të viteve 1909-1912, ndërtimit të FA-së pas Shpalljes së Pavarësisë, të Luftës së Vlorës të vitit 1920, të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe pas Luftës së Dytë Botërore etj. Ajo që e dallon FEUSH-i është se përshkohet nga karakteri kombëtar shqiptar me shtrirje në të gjitha trojet shqiptare në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoninë e Veriut, në Greqi dhe në diasporë.

Trajtohet për herë të parë dhe gjerësisht tematika e gjeografisë ushtarake, vendet e dëgjura në veprimet luftarake, për vendbanime të njohura të lidhura me ngjarje ushtarake të rëndësishme, për ndikimin e faktorëve gjeografike dhe të dukurive atmosferike në veprimet ushtarake etj. Në fjalor gjenden dhe të dhëna tekniko-shkencore për sistemet e armatimit e të teknikës, të llojeve të armëve, të modeleve dhe të klasifikimit e tyre, përfshirë dhe modelet e armëve të prodhuara në vendin tonë dhe të përdorura në luftërat e pandërprera për liri e pavarësi. Vend të veçantë zënë dhe zëra të fushës teknike, si aparate, aparatura, pajisje etj., duke dhënë një pamje të plotë të gjendjes së inventarit

të teknikës që ka qenë në përdorim, por dhe çështje nga fusha e elektronikës dhe informatikës.

Vend të rëndësishëm zënë dhe personalitetet ushtarake shqiptare

Fjalori përmban mbi 1 000 zëra jetëshkrimorë të personaliteteve ushtarakë, si mbretër e princër të trevave iliro-shqiptare me veprimtari të theksuar në fushën ushtarake, prijës e udhëheqës të njohur popullorë, komandantë të çetave atdhetare e luftëtarë të shquar në lëvizjet, kryengritjet dhe luftërat e popullit tonë për çlirim e bashkim kombëtar gjatë gjithë historisë. Është mbajtur parasysh që të përfshihen në radhë të parë oficerë madhorë të ushtrisë shqiptare ose me prejardhje shqiptare brenda ose jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë, të cilët janë vlerësuar për ndihmesat ushtarake ku kanë shërbyer, si dhe pjesëmarrës të dalluar në luftërat për liri të popujve të tjerë. Në vëmendje kanë qenë dhe drejtues të shquar të lidhjeve, besëlidhjeve, kuvendeve, shoqërive politike e shoqërore, veprimtarë të dalluar të lëvizjes kombëtare e demokratike, atdhetarë të paepur për mbrojtjen e çështjes kombëtare, dëshmorë dhe heronj të popullit. Në fjalor pasqyrohen dhe figura që krijuan e udhëhoqën formacionet ushtarake në LANÇ-it, anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së, drejtues të njësive partizane në shkallë brigade e lart, anëtarë të shtabeve të Ballit Kombëtar, të Legalitetit dhe komandantë të forcave ushtarake nacionaliste.

Në fjalor përfshihet periudha e Luftës së Ftohtë me shefa e zëvendës shefa të Shtabit të përgjithshëm të Ushtrisë, komandantë të llojeve të forcave, të korpuseve e divizioneve, drejtorë të Drejtorisë

Operative dhe të Zbulimit të MM, komandantë të shkollave të larta ushtarake, shefa të katedrave mësimore e të degëve shkencore në Akademinë e Mbrojtjes dhe në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, etj. Vend përfaqësimi kanë dhe nismëtarë të krijimit dhe drejtues kohë-gjatë të llojeve të armëve e shërbimeve, të njësive dhe institucioneve mësimore. Vend zënë dhe kuadro ushtarakë të nivelit nënkolonel e lart me grada e tituj shkencorë, që me punimet e tyre kanë dhënë ndihmesë të shënuar në sferën e veprimtarisë kërkimore-shkencore e të hulumtimit të mendimit ushtarak shqiptar.

Në fjalor kanë gjetur pasqyrim dhe ushtarakë me vlera të spikatura në sferën e veprimtarisë krijuese letrare, si dhe të vlerësuar me tituj nderi në fushën e arteve dhe të sporteve. Për kuadrot me kohë shërbimi në FA, gjatë periudhës së heqjes së gradave në vitet 1966-1991, nuk janë pasqyruar gradat ushtarake, në ushtrimin e detyrave si oficerë madhorë në funksionet e larta ushtarake. Gjenden në fjalor dhe personalitete ushtarake e civile të huaja që me veprimtarinë e tyre kanë ndikuar në dobi apo në dëm të çështjes shqiptare, si dhe veprimtarë ushtarakë shqiptarë që kanë punuar kundër interesave kombëtare. Në fjalor nuk janë përfshirë figura politike të qeverisë shqiptare, që nuk kanë lënë gjurmë në fushën ushtarake. Për hartimin e të gjithë zërave është bërë konsultimi dhe me "Fjalorin Enciklopedik Shqiptar" të viteve 1985 dhe 2008, si dhe të "Fjalorit Biografik Ushtarak" të vitit 2006 me autor Kujtim Halilin.

Vlerat shkencore të fjalorit

Fjalori ka një stil të veçantë në dhënien e informacionit të përpiktë dhe të kuptueshëm. Aty gjenden përcaktime dhe vlerësime përgjithësuere, ilustrime të zgjedhura kryesisht për armët. Ky fjalor pasqyron përgjithësisht mendimin teoriko-ushtarak dhe FA-ve të Shqipërisë deri në vitin 2010. Shumë zëra, si emërtime organizatash e institucioneve, dukuri të koncepteve e të doktrinës ushtarake, veçori të armëve, të pajisjeve, të prodhimit të tyre, struktura të komandimit, etj., janë në përshtatje me këndvështrimin e periudhës kohore përkatëse.

Në fjalor janë përfshirë zëra për zhvillimet në ushtri të pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, mendimi teorik ushtarak bashkëkohor, zhvillimi i mendimit e aftësive ushtarake, çështje të sigurisë ndërkombëtare, rajonale e kombëtare, probleme ushtarake të ligjeve dhe të konventave ndërkombëtare, të operacioneve paqeruajtëse etj. Vend të veçantë kanë zërat nga fusha e doktrinës dhe terminologjisë së NATO-s.

Botimi i fjalorit enciklopedik ushtarak është një arritje e madhe për dukuritë dhe çështjet kryesore në fushën ushtarake. Fjalori nuk është shterues, ai çdo ditë duhet të pasurohet me gjetje të reja që në botimin e ardhshëm të jetë më i plotë. Falënderime për të gjithë kontribuuesit, për autorët dhe për recentët.

Laboratori

Forca TOKËSORE



Ky laborator synon rritjen e mëtejshme të kualitetit të shërbimit diagnostifikues shëndetësor të personelit që shërben në FT.

Hapet në ambientet e Forcës Tokësore, Laboratori Klinik-Biokimik-Hormonal

Hapet për herë të parë, Laboratori Klinik-Biokimik-Hormonal i kryerjes së ekzaminimeve laboratorike në Forcën Tokësore.

Laboratori siguron cilësinë e ekzaminimeve duke respektuar udhëzuesit teknik laboratorik, si dhe duke kryer dhe evidentuar procedurat e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Ky laborator synon rritjen e mëtejshme të kualitetit të shërbimit diagnostifikues shëndetësor të personelit që shërben në FT.

Efektivët e FT-së mund të kryejnë një gamë të gjerë analizash mjekësore, nga ku dhe rezultatet e analizave të gjakut janë të disponueshme falë kartelave dhe regjistrit elektronik personal.



Batalioni i Parë i Këmbësorisë zhvilloi me sukses stërvitjen fushore-ujore "Rreth Grethi 22-01"

